



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 26 nëntor 2019**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1211\_2019**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 4, nenin 5, nenin 6 nenin 13 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, nenin 14, nenin 15 paragrafi 1 dhe nenin 16 paragrafin 1,2,3 dhe 4 të Rregullës Nr. 11/2017 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në burimet e ripërtitshme të energjisë;
- Nenin 11 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 7, nenin 12, nenin 17 paragrafi 5, të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve;
- Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Ripërtitshme të Energjisë;
- Vendimin nr. V\_810\_2016, të datës 19 maj 2016, për përcaktimin e Tarifës nxitëse (Feed in) për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtitshme të Energjisë;
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, Wind Park – BUDAKOVA - 1, në vendin e quajtur Budakova, ZK Budakov, me kapacitet të instaluar prej 11 MW, në Komunën e Suharekës, Republika e Kosovës;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_987\_2019 të datës 13 qershor 2018 të lëshuar shoqërisë "Bondcom Energy Point" SH.P.K., me të cilën ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, Wind Park – BUDAKOVA -1 në vendin e quajtur Budakova, ZK Budakov, me kapacitet të instaluar prej 11 MW, në Komunën e Suharekës, Republika e Kosovës;
- Kërkesën/aplikacionin për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, Wind Park – BUDAKOVA -1 në vendin e quajtur Budakova, ZK Budakov, me kapacitet të instaluar prej 11 MW, në Komunën e Suharekës, të datës 11.12.2019, të shoqërisë "Bondcom Energy Point" SH.P.K., me adresë: rruga "Muharrem Fejza" Mati 1, Prishtinë, Republika e Kosovës, dhe
- Kontratat, lejet, pëlqimet dhe vendimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse, si në shtojcën II. të këtij vendimi,

**në seancën e mbajtur më 26 dhjetor 2019 nxori këtë:**



## V E N D I M PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT FINAL

- I. I lëshohet **AUTORIZIMI FINAL** shoqërisë “**Bondcom Energy Point**” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA, **WIND PARK – BUDAKOVA - 1** në vendin e quajtur Budakova, parcelat kadastrave P -72116004-00933-0 (dy fluturake) dhe P-72116004-00935-0 (një fluturake) ZK Budakov, me kapacitet të instaluar prej **11 MW**, në Komunën e Suharekës, sipas Lejes Ndërtimore Nr. 6937-2/19 datë 11.12.2019 dhe numri i vrojtimit të lejes K.III-014/2019 të datës 10.12.2019 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- II. Vendimi për Autorizim Final i lëshohet shoqërisë “**Bondcom Energy Point**” SH.P.K., sipas planit dinamik të ekzekutimit të punimeve prej tre (3) vite e katër (4) muaj, gjegjësisht deri me 26 prill 2023 dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të ndërtoj stabilimentet e reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin të finalizuar nga data e lëshimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
- IV. Shoqëria “**Bondcom Energy Point**” SH.P.K., do të lidh Marrëveshjen për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut (KOSTT) në kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) vjeçare, e cila do të lidhet brenda tridhjetë (30) dite nga data e lëshimit të këtij vendimi, me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V\_810\_2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.
- V. Shoqëria “**Bondcom Energy Point**” SH.A., obligohet që të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) të lëshuar nga MMPH.

### Arsyetim

- o ZRRE me datë 19.12.2017 nga shoqëria “**Bondcom Energy Point**” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga ERA Wind Park – BUDAKOVA -1, në vendin e quajtur Budakovë, ZK Budakova, me kapacitet të instaluar prej 11 MW, në Komunën e Suharekës, Republika e Kosovës.
- o ZRRE, pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Turbinat e Erës, më 13 qershor 2019 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_987\_2018 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t’i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_987\_2018, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.



- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar është lëshuar në afat një (1) vjeçar dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë “Bondcom Energy Point” SH.P.K., do t’i jepet Autorizimi Final për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final, duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
  - Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse, dhe garantimin e lidhjes së Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë (MBE) në kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) vjeçare.
  - ZRRE me datë 11.06.2019 nga shoqëria “Bondcom Energy Point” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Autorizimin Preliminar, për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final, për ndërtimin e Turbinave të Erës, në lokacionin ZK Budakov, me kapacitet të instaluar prej 11 MW Komuna e Suharekës, edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me 13 dhjetor 2019.
  - Bordi i ZRRE me datë 10 korrik 2019 me Vendimin V\_1169\_2019 ka aprovuar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Autorizimin Preliminar V\_987\_2018 të datës 13 qershor 2018, për kompletimin e aplikacionit edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht deri me 13 dhjetor 2019.
  - ZRRE, më datë 11.12.2019, brenda afatit ligjor nga shoqëria “Bondcom Energy Point” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga ERA Wind Park – BUDAKOVA 1, në vendin e quajtur Budakovë, ZK Budakova, me kapacitet të instaluar prej 11 MW, në Komunën e Suharekës, Republika e Kosovës, duke i bashkëngjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Marrëveshjen për Kyçje dhe Lejen Ndërtimore nga MMPH, si dhe kërkesat tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
  - ZRRE, pas vlerësimit të dëshmimeve të bashkëngjitura dhe lejeve, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara nga institucionet përgjegjëse dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- VI. ZRRE sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij Vendimi, do të monitoroj implementimin e projektit Wind Park BUDAKOVA -1 me kapacitet të instaluar prej 11 MW, së paku një (1) herë në vit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- VII. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, çilado që ndodh e fundit.

*Bashkëngjitur Vendimit janë Shtojca I dhe Shtojca II.*

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Suharekës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.



## SHTOJCA I

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) duke ushtruar kompetencat e dhëna me nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe në përputhje me Nenin 16 të Rregullës Nr. 11/2017 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në BRE, shoqërisë "Bondcom Energy Point" SH.P.K., me adresë: rruga "Muharrem Fejza" Mati 1, Prishtinë, Republika e Kosovës, më 26 dhjetor 2019, i lëshon këtë:

### AUTORIZIM

1. Për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Turbinat e Erës Wind Park BUDAKOVA 1, në Lokacionin parcelat kadastrave P -72116004-00933-0 (dy fluturake) dhe P-72116004-00935-0 (një fluturake) ZK Budakov, me kapacitet të instaluar prej **11 MW**, Komuna e Suharekës, sipas Lejes Ndërtimore Nr. 6937-2/19 datë 11.12.2019 dhe numri i vrojtimit të lejes K.III-014/2019 të datës 10.12.2019 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
2. Me këtë Autorizim autorizohet shoqëria "Bondcom Energy Point" SH.P.K., që të ndërtoj kapacitetet gjeneruese në lokacionin e caktuar më lart, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Autorizim.
3. Ky Autorizim lëshohet sipas planit dinamik për tre (3) vite e katër (4) muaj, gjeigjesisht deri me 26 prill 2023 duke filluar nga data e lëshimit të tij.
4. Pala e Autorizuar, gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së këtij Autorizimi, duhet të plotësojë:
  - a. të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë Autorizim, dhe
  - b. të gjitha kushtet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe ato për mjedisin.
5. Zyra e Rregullatorit për Energji mund ta bëjë modifikimin e këtij Autorizimi në përputhje me dispozitat e nenit 21 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
6. Në rast se pala e Autorizuar falimenton para se të ndërtohet stabilimenti gjenerues i autorizuar, atëherë ky Autorizim do të pezullohet dhe do të mbetet i tillë derisa ZRRE përcakton se janë arritur kushtet për tërheqjen e pezullimit. Derisa ky Autorizim është i pezulluar e tërë puna e mëtutjeshme në ndërtimin e stabilimentit gjenerues të autorizuar duhet të ndërpritet. Në rast të kundërt, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
7. Vlefshmëria e këtij Autorizimi do të përfundojë me skadimin e afatit të përcaktuar në dispozitivin nën pikën II. të këtij Vendimi.
8. Në rast se pala e Autorizuar bën shkeljen e ndonjërit prej kushteve të këtij Autorizimi dhe të dispozitave ligjore në fuqi, ZRRE do të pezullojë këtë Autorizim në përputhje me dispozitat e Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja. Nga data e pezullimit të Autorizimit e tërë puna e mëtutjeshme në stabilimentin e autorizuar do të ndërpritet. Në rast të mos respektimit të kushteve ligjore, ndaj palës së Autorizuar mund të ndërmerren masat administrative dhe gjobat të përcaktuara sipas legjislacionin në fuqi.
9. Pala e autorizuar duhet ta njoftoj me shkrim ZRRE-në dhe të kërkojë pëlqimin paraprak për çdo ndërrim të ndonjë pjese të elementeve ekzistuese të gjeneratorëve apo shtim të elementeve të reja, e që nuk janë të përfshira në projektin që është pjesë e aplikacionit.



## SHTOJCA II

Lista e dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave etj.) të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me marrjen e **Autorizimin Final për Ndërtim të shoqërisë "Bondcom Energy Point" SH.P.K.**, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Turbinat e Erës Wind Park BUDAKOVA -1, në Budakov, me kapacitet të instaluar prej 11 MW, ZK Budakova, Komuna e Suharekës:

- **Pëlqimin 08 Nr. 141/17** të datës 13.07.2017 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari, Komuna e Suharekës.
- **Pëlqimin Nr. KE-630/17** të datës 31.10.2017 të lëshuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës.
- **Kontratën për Qiranë e Tokës Pyjore Nr. KE-631/17** të datës 31.10.2017 të lëshuar nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës.
- **Vendimin për Autorizimin Preliminar V\_987\_2018** të datës 13 qershor 2018, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.
- **Vendimin V-1169\_2019** të datës 10 korrik 2019 për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Preliminar të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së.
- **Pëlqimin Mjedisor - Nr. 17/4649/1-665/DMMU** i datës 07.12.2017 i lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) –Zyra e Sekretarit Permanent (ZSP);
- **Marrëveshja e Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit të Kosovës Nr. 1880** e datës 18.11.2019 i lëshuar nga KOSTT.
- **Kushtet Ndërtimore – Nr. 3328-2/2019** të datës 14.10.2019 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- **VENDIMI PËR LEJE NDËRTIMORE – Nr. 6937-2/19** të datës 11.12.2019 dhe numrit të vrojtimit të lejes K.III. – 14/2019 për Lejimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Turbinat e Erës, në parcelat kadastrave P -72116004-00933-0 (dy fluturake) dhe P-72116004-00935-0 (një fluturake) ZK Budakov, me kapacitet të instaluar prej **11 MW**, Komuna e Suharekës, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- **Planin dinamik të ekzekutimit të punimeve**
- **Certifikatat e ngastrave kadastrale dhe kopjet e planit**
- **Studimi i Fizibilitetit teknik, mjedisor dhe financiar**
- **Plani i Biznesit**
- **Projekti i Zbatimit.**